



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
Komuna e Dragashit
Opština Dragaš

01 Nr. Br. 052/01-3894/26
04.03.2026
Dragash - Dragaš

Republika e Kosovës

Republika Kosovo/Republic of Kosovo

Komuna Dragash/ Opština Dragaš/Dragas Municipality



PLANI I PUNËS

I KRYETARIT DHE ORGANEVE
EKZEKUTIVE PËR VITIN 2026



Plani Vjetor i Punës i Kryetarit dhe Organeve Ekzekutive për vitin 2026 paraqet dokumentin bazë orientues për organizimin, koordinimin dhe realizimin e aktiviteteve institucionale gjatë vitit kalendarik. Ky plan synon të sigurojë një qeverisje efikase, transparente dhe të përgjegjshme ndaj qytetarëve të Dragash, duke harmonizuar prioritetet zhvillimore me obligimet ligjore dhe strategjitë komunale.

Plani është hartuar mbi parimet e:

- Llogaridhënies dhe transparencës publike;
- Efikasitetit institucional;
- Barazisë gjinore dhe përfshirjes sociale;
- Sundimit të ligjit;
- Bashkëpunimit ndërinstitutional dhe partneritetit me komunitetin;

Përveç aktiviteteve të drejtpërdrejta të Kryetarit, si udhëheqja e proceseve vendimmarrëse, përfaqësimi institucional dhe komunikimi me qytetarët, dokumenti përfshin edhe aktivitetet e integruara të njësive mbështetëse brenda Zyrës së Kryetarit, përfshirë:

- Zyrën për Barazi Gjinore;
- Zyrën Ligjore;
- Zyrën për Marrëdhënie me Publikun;
- Zyrën e Auditorit të Brendshëm; dhe
- Zyrën për Integritet Evropian.

Struktura e mëposhtme tabelare e Planit mundëson përcaktim të qartë të objektivave, aktiviteteve kryesore, afateve dhe përgjegjësi, duke krijuar një instrument praktik për monitorim dhe vlerësim të vazhdueshëm të performancës.

Ky Plan do të shërbejë si udhërrëfyes për punën e Zyrës së Kryetarit dhe Organeve Ekzekutive të Komunës së Dragashit gjatë vitit 2026 dhe si bazë për raportimin periodik para Kuvendit Komunal dhe qytetarëve, me qëllim forcimin e besimit publik dhe përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve komunale.

Fusha	Objektivi	Aktivitetet Kryesore	Koha	Përgjegjës
Udhëheqja dhe Vendimmarrja	Rritja e performancës institucionale	Mbledhje javore me drejtorë; Monitorim i projekteve kapitale; Monitorimi i punës së drejtorive komunale; Vendime Strategjike	Gjatë gjithë vitit	Kryetari / Drejtorët
Takime dhe Përfaqësim Zyrtar	Forcimi i bashkëpunimit institucional	Takime me Kuvendin; Donatorë; Vizita në terren; Ceremoni Zyrtare; Takime me institucione ndërkombëtare të vendosura në Kosovë; Takime me përfaqësues të institucioneve të Republikës së Kosovës nga niveli qendror dhe lokal	Sipas kalendarit mujor	Kryetari
Takime me Qytetarë	Rritja e transparencës dhe llogaridhënies	Trajtim ankesash; Takime në fshatra	Gjatë gjithë vitit	Kryetari

Zyra për Barazi Gjinore	Integrimi i perspektivës gjinore	Plan veprimi gjinor; Trajnime; Aktivitete gjinore; Raportim indikatorësh	Gjatë gjithë vitit	Zyrtarja për Barazi Gjinore
Zyra Ligjore	Sigurimi i ligjshmërisë	Shqyrtim dhe hartim vendimesh; Hartim kontratash; Përfaqësim gjyqësor; Raporte të rregullta	Gjatë gjithë vitit	Zyra Ligjore
Zyra për Marrëdhënie me Publikun	Informim profesional dhe transparent	Komunikata; Menaxhim i uebfaqes dhe rrjeteve sociale; Raportim i rregullt	Gjatë gjithë vitit	Zyra Për Marrëdhënie me Publikun
Zyra e Auditorit të Brendshëm	Forcimi i kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar	Realizimi i auditit meve të brendshme; Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm; Identifikimi i rreziqeve; Dhënia e rekomandimeve për përmirësim; Raportim tek Kryetari	Periodike	Zyra e Auditorit të Brendshëm
Integrime Evropiane	Rritja e fondeve dhe projekteve	Aplikime për projekte; Koordinim me ministri; Raportim për Standarde dhe realizim të Agjendës Evropiane	Sipas thirrjeve	Zyra për Integrime



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA- REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA DRAGASH/OPŠTINA DRAGASH / MUNICIPALITY OF DRAGASH

Drejtoria e Administratës – Direktorat za Administraciju - Directorate of Administration



Data/Date/ Datum;	25.02.2026
Për / To/Za :	Zyrën e Kryetarit
Nga /From/ Od	Drejtoria e Administratës
Lënda/Subject/Tema:	Plani i Punës për vitin 2026

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
Komuna e Dragashit
Opština Dragaš

02 Nr. Br. 052/01-3472/26
25.02.2026
Dragash - Dragaš

PLANI I PUNËS

2026

Shkurt, 2026



HYRJE

Duke u bazuar në Ligjin Nr.03/L-040 mbi Vetëqeverisjen Lokale, Ligjin Nr.03/L-149 mbi Sherbimin Civil, Ligjin Nr.04/L-003 për Gjendjen Civile, Udhëzimeve Administrative, Statutin e Komunës, Rregulloret Komunale, urdhëresat dhe udhëzimet komunale që specifikojnë rregullat dhe modalitetet e aplikimit të Ligjit dhe veprimit administrativ, Drejtoria e Administratës Komunale do të ushtrojë aktivitetin në të gjithë sektorët e saj organizativ si në vijim:

- Sektori i Gjendjes Civile (Ofiqaria);
- Zyra për Shërbime të Qytetarëve dhe Arkivi;
- Zyra e Prokurimit;
- Shërbimet teknike;
- Njësia për IT.

Për te siguruar një punë efikase, Drejtoria e Administratës përgatit Planin e Punës për vitin 2026, në të cilin plan do të paraqiten objektivat dhe dinamika e arritjes së këtyre objektivave për këtë vit.

Qëllimi i këtij dokumenti është që të përgatisim një plan menaxhimi të bazuar në kapacitete organizative dhe teknike, përmirësim të kushteve të punës, performancës së deritashme dhe shfrytëzimit sa më të mirë të kapaciteteve që ka kjo drejtori, me qëllim rritjen e nivelit të performancës dhe ofrimit të shërbimeve për qytetarët.

Zbatimi i përvojës që është krijuar nga stafi i sektorëve dhe mundësia e përmirësimit të shërbimit për secilin sektor do të jetë sfidë dhe objektiv i ynë i përbashkët.



RËNDËSIA DHE HAPAT

Rëndësia e këtij Plani qëndron në mundësinë e eliminimit të dobësive që kanë përcjellur Administratën Komunale nga viti paraprak dhe që kanë ndikuar drejtëpërdrejt në performancë. Menaxhimi i bazuar në performancë është një qasje që në mënyrë sistematike mundëson përmirësimin e performancës përmes një procesi të vazhdueshëm të vendosjes së objektivave, matjes së performancës përmes grumbullimit, analizimit dhe rishikimit të të dhënave.

Vlerësojmë se Plani Vjetor i Punës duhet të bazohet në performancë e jo në numër të aktiviteteve, sepse rezultatet janë ato që flasin.

Dinamika e punës sipas këtij Plani duhet të përcillet çdo javë, me qëllim që mos të ketë ngecje në përmbushjen e objektivave, por në mënyrë sistematike të përcillen të arriturat të përcaktuara në këtë Plan.

Problemet sikurse janë mungesa e hapësirave të nevojshme dhe kushteve optimale tashmë janë përmirësuar dhe jemi në kërkim e sipër edhe të zgjerimit të mëtejshëm të hapësirave ekzistuese. Procesi i filluar tashmë i digjitalizimit të shërbimeve administrative dhe rregullimi i statusit të zgjidhjes së lëndëve mbetet gjithashtu sfidë edhe këtë vit.



Sektori i Gjendjes Civile

❖ Objektivat

1. Regjistrimi i lindjeve, martesave dhe vdekjeve brenda dhe jashtë vendit

1.1 Dhënia e infomatave korrekte dhe infomimi për procedurat e regjistrimit të lindjeve, martesave dhe vdekjeve;

1.2 Perpjekja që qytetarët të jenë të kënaqur me kohën dhe shërbimet e mira.

2. Lëshimi i dokumenteve të Gjendjs Civile

2.1 Lëshimi i dokumenteve të GJC në kohë optimale dhe tani me UA të MPB nr.01/2022 lëshohen me QR Code që nënkupton vërtetimin e autenticitetit, duke zbatuar legjislacionin në fuqi të RKS.

3. Përcjellja e punës dhe aktiviteteve të të gjithë zyrtarëve të sektorit të Gjendjes Civile.

3.1.Punë efikase, shërbime dhe rezultate më të mira;

3.2 Përmirësim i kushteve të punës, furnizimi i zyrave me orman metalik, karrige dhe tavolina te punës dhe stol qëndrimi për palët, si dhe vendosja e një printeri multifunksional në shërbim të qytetarëve gjatë sezonës kur ka fluks më të madh të qytetarëve.

4. Bashkëpunimi i ngushtë me ministritë përkatëse MPB, MAPL, MAP, si dhe departamentet që operojnë në këto ministri

4.1 Bashkëpunim me DRGJC –ARC në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme;

4.2 Bashkëpunim me sektorët e Teknologjisë Informative për programet që përcjellin punën dhe veprimtarinë tonë;

4.3. Për vitin 2026 jemi të përgatitur që të zbatojmë çdo direktivë, udhëzim nga ARC-MPB sa u përket kërkesave që vijnë në kuadër të liberalizimit të vizave dhe realizimit të standardeve europiane.

5. Raportimi i punës në sektorin e Gjendjes Civile

5.1 Raportet javore, mujore dhe vjetore në forma tabelare me statistikat përkatëse për lindjet, martesat dhe vdekjet. Po ashtu, me këto të dhëna njoftohet edhe Enti i Statistikës së Republikës së Kosovës.

6. Zbatimi i ligjeve dhe udhëzimeve të reja në sektorin e Gjendjes Civile

6.1 Përcjellja në kohë e njoftimeve dhe informacioneve tek zyrtarët e Gjendjes Civile.



Zyra për Shërbime të Qytetarëve dhe Arkivi

❖ Objektivat

- Zyra për Shërbimin e Qytetarëve do të funksionojë si pjesë e strukturës organizative të Administratës së Komunës;
- Çdo shërbim publik që ofron Komuna, duhet të protokollohet përmes zyrës dhe secila drejtori duhet të jetë e lidhur me këtë zyrë;
- Zyra do të pranojë dhe procedojë për shqyrtim dhe vendosje kërkesat e qytetarëve në drejtoritë komunale dhe njësitë organizative brenda drejtorive;
- Zyra ofron shërbime tjera si vijon: shërbimet e arkivës, shërbimet e gjendjes civile, tatimin në pronë, shërbimet kadastrale dhe të gjitha shërbimet tjera;
- Zyra duhet të këshillojë dhe të ndihmojë në çështjet teknike-administrative për mënyrën e plotësimit të kërkesave;
- Do të bëjë pranimin dhe regjistrimin e kërkesave;
- Do të bëjë mbajtjen e dosjeve, statistikave të kërkesave të paraqitura nga qytetarët;
- Gjithashtu, do të protokollojë të gjitha aktet e nxjerra nga organet e Komunës;
- Do të vazhdojë implementimin dhe përditësimin e të dhënave në kohë reale në sistemin e INTRANET-it.

Zyra e Prokurimit Publik

Kjo zyrë, përveç realizimit të buxhetit të aprovuar nga Asambleja Komunale për investime kapitale dhe shpenzime të ndryshme që ka komuna, gjithashtu do të përkujdeset për ofrimin dhe procesimin e të gjitha kërkesave dhe nevojave që vijnë nga drejtoritë komunale.

Në mënyrë që projektet të realizohen me sukses për ta arritur një përqindje të konsiderueshme të realizimit të buxhetit që është paraparë për vitin 2026, Zyra e Prokurimit do të bashkëpunojë ngushtë me të gjitha drejtoritë komunale, si në projektet e investimeve kapitale, poashtu edhe me furnizimet e nevojshme për organet e administratës komunale.

Po ashtu, me qëllim ngritjen e transparencës, e gjithë veprimtaria e Zyrës së Prokurimit do të publikohet në webfaqen e Komunës, si dhe në platformën eProkurimi.



Shërbimet Teknike

❖ Njësia e Autoparkut Komunal

Njësia e Autoparkut të Komunës është planifikuar në atë mënyrë që:

- Të gjithë përdoruesit e automjeteve duhet që të përdorin automjetet zyrtare në mënyrë sa më ekonomike dhe efikase;
- Do të bëhet mirëmbajtja e simboleve apo shenjave identifikuese të Komunës së Dragashit tek automjetet zyrtare;
- Do të bëhet servisimi i rregullt i automjeteve në mënyrë që automjetet të jenë vazhdimisht në dispozicion për kryerjen e detyrave zyrtare;
- Varësisht nga kostoja, do të shqyrtohet mundësia e pajisjes me GPS e të gjitha automjeteve zyrtare.

❖ Sigurimi i Objekteve Komunale

Sigurimi i Objektivit të Komunës do të kryejë punën sipas aktivitetit si në vijim:

- Do të jetë në gjendje që gjatë natës të kujdeset për objektin e Komunës;
- Do të përcjellë sigurinë e objektit;
- Do të mundohet që të parandalojë rreziqet që mund të paraqiten gjatë natës;
- Do të mbajë evidencë për hyrje-daljen e zyrtarëve gjatë natës;
- Do të adresojë problemet eventuale që mund të paraqiten gjatë punës.

❖ Shërbimi i pastrimit:

Ky shërbim do të kujdeset që hapësirat e objektit të Komunës të jenë të pastërta, duke u kujdesur për secilën hapësirë të komunës dhe të objektit të ZGJC-Dragash.

Gjithashtu, nevojat për mjete pastrimi do t'u sigurohen në bazë të kërkesave të tyre pranë Deposë së Komunës dhe konform kontratave të cilat organizohen nga Zyra e Prokurimit.



Njësia e Teknologjisë Informative

Objektivat apo planet e njësisë së IT-së për vitin 2026 janë si në vijim:

- Mirëmbajtja e pajisjeve teknologjike për të gjithë punëtorët e Administratës;
- Zhvendosja e lokacionit të dhomës së serverëve (Server Room) në një hapësirë më të madhe;
- Përmirësimi i infrastrukturës së rrjetit, hartimi i planit detal të LAN-it dhe implementimi i projektit;
- Instalimi i sistemit të ri të monitorimit të kamerave për objektin e Komunës së Dragashit;
- Asistencë në implementimin e sistemit të INTRANET-it për të gjithë punëtorët e Administratës Komunale.




Veton Halili
Drejtor i Drejtorisë së Administratës



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
Komuna e Dragashit
Opština Dragaš

02 Nr. Br. 052/01-3365/26
24.02.2026
Dragash - Dragaš



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
Kuvendi i Komunës së Dragashit - Skupstina Opštine
Dragas

Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim – Direktorijat Ekonomije, Finansije i Razvoja

Datë/a-Datum	30.01.2026
Referenc-ë	
Për-Za :	Kryetarin Bexhet Xheladini dhe kuvendin e komunës së Dragashit
Përgatitur nga	Drejtori Ekonomisë Financave dhe Zhvillim
Përmes-Preko :	E-mail dhe Arkivit
Nga-Od :	Qamil Kolloni - Drejtor i Ekonomisë Financave dhe Zhvillim
Tema :	Plani i punës i drejtorisë për Ekonomi Financa dhe Zhvillim - 2026

Plani i punës i drejtorisë për Ekonomi Financa dhe Zhvillim - 2026

Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim i komunës së Dragashit, duke pas për bazë detyrat, obligimet dhe përgjegjësitë që dalin nga dispozitat ligjore dhe statuti i komunës së Dragashit, punën dhe veprimtarinë e vetë në vitin 2026 do ta përqendrojë në:

1. Menaxhimin e buxhetit në bazë të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi, Ligjit mbi Financat e Pushtetit Lokal, Udhëzimeve Administrative dhe rregullave financiare të lëshuara nga MF dhe Komuna.

2. Monitorimin e regjistrimeve efikase dhe të sakta të të gjitha të hyrave, si dhe lehtësimin e rrjedhës së lirë të shpenzimeve në një mënyrë që është në konsistencë me rregullat e duhura të menaxhimit financiar dhe të bëjë regjistrimin e saktë të tyre.
3. Të përgatiten raporte financiare sipas kërkesave të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike në pajtim me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit të sektorit publik i bazuar në paratë e gatshme dhe me statistikat qeveritare.
4. Të plotësohen nevojat për informata nga ana e palëve kryesore të interesuara, duke përfshirë Kuvendin, Qeverinë, Donatorët, komunitetin dhe publikun.
5. Të siguroj që të bëhet barazimi sipas kërkesave të LMFP në mes të SIMFK-së dhe Organizatës buxhetore.
6. Rritja e efikasitetit në punë në arkëtimin e të hyrave vetanake, tatimit në pronë, taksave dhe ngarkesave të ndryshme komunale dhe mundësia e gjetjes së burimeve tjera financiare, përmes donacioneve apo formave tjera,
7. Rritja e transparencës në nivelin më të lartë, para qytetarëve në grumbullimin, shfrytëzimin dhe shpenzimin e parasë publike.
8. Propozimi i rregulloreve financiare në asamblenë komunale.
9. Përgatitjen dhe hartimin e strategjisë për zhvillim ekonomik lokal.

PLANI I PUNËS PËR PERIUDHËN JANAR - DHJETOR 2026

Nr	Përshkrimi i detyrave të planifikuara	Afati
1	Punët përgatitore për fillimin e vitit buxhetor sipas Udhëzimit Administrativ - punimi dhe dorëzimi i planit të rrjedhjes së parasë së gatshme në Ministrinë e Financave-Departamenti i Thesarit-ZKF	Janar 2026
2	Barazimi i të hyrave dhe shpenzimeve me të dhënat në SIMFK Sipas afateve të caktuara nga ana e MEF- it Departamentit të Thesarit. -ZKF	Deri 31 janar 2026
3	Përgatitja dhe dorëzimi i Pasqyrave financiare për vitin e përfunduar më janar-dhjetor 2025 të punuara sipas rregulloreve financiare- ZKF	29.01.2026
4	Regjistrimi dhe raportimi mbi të hyrat vetanake të komunës	Detyrë e përhershme
5	Regjistrimi dhe ekzekutimi i urdhërpagesave në SIMFK	Detyrë e përhershme
6	Regjistrimi i pasurisë mbi 1000 euro ne SIMFK dhe regjistrimi ne e- pasuri nen 1000 euro.	Detyre e përhershme
7	Regjistrimi i bizneseve, konsulta të ndryshme rreth bizneseve, mbajtja e kontratave pasi qe ato te nënshkruhen për ngarkim te qirasë, pagesa e qirave ne baza mujore.	Detyre e përhershme
8	Përgatitja e nismës për inicimin e shpenzimeve për investime kapitale.	Shkurt 2026

9	Shtypja e faturave, specifikat dhe vlerësimet e tokave për tatimpaguesit të cilët jetojnë në Komunën e Dragashit. Informimi i tatimpaguesve rreth aplikimit të tatimit në tokë.	Shkurt 2026
10	Shpërndarja e faturave të tatimit në pronë Lëshuara e aktvendimeve mbi ngarkesën e qirave vjetore për shfrytëzimin e tokës ndërtimore, Barazimi i të hyrave vetanake dhe shpenzimeve me të dhënat nga SIMFK.	Shkurt-Mars Mars Fundi i Marsit
11	Pranimi i ankesave dhe vërejtjeve nga qytetaret për faturat e tatimit në prone.	Mars
12	Bartja e të hyrave vetanake të pashpenzuara.	Mars-Prill 2026
13	Raporti periodik mbi shpenzimin e mjeteve buxhetore për periudhën janar –mars 2026.	Fundi i prillit 2026
14	Përgatitja dhe hartimi i strategjisë për zhvillim ekonomik lokal.	Mars-Dhjetor
15	Raporti mbi numrin e bizneseve të regjistruara pranë qendrës për regjistrimin e bizneseve në Dragash.	15 prill 2026
16	Seleksionohen, verifikohen dhe printohen faturat e borxhlinjve më të mëdhenj të tatimit në pronë përsëri të shpërndahen faturat dhe nëse nuk paguhen borxhet të ndërmerren masa të parapara me ligj për pagese të detyruar.	Maj 2026
17	Regjistrimi i të gjitha objekteve të reja të ndërtuara dhe verifikimi i objekteve tjera ekzistuese lëshimi i	Detyre e përhershme

	vërtetimeve dhe dokumenteve (vërtetimi për regjistrim te automjetit, për ndihma sociale, për viza etj.)	
18	Bartja e shitblerjeve të kontratave dhe bashkëpunimi me MEF, Departamenti i tatimit ne pronë.	Detyrë e përhershme
19	Raporti mbi inkasimin e mjeteve nga shfrytëzimi i tokës dhe objekteve ne pronësi te komunës me karakter te përkohshëm.	Detyrë e përhershme
20	Pagesa e tatimit, lëshimi i certifikatave të ndryshme për pagesën e tatimit dhe regjistrimi i objekteve të reja.	Detyrë e përhershme


21

	Paraditja dhe procedimi i urdhër zotimeve për pagesë.	Detyrë e përhershme
22	Përgatitja e raportit të shpenzimeve dhe të hyrave për periudhën janar-qershor 2026.	Korrik 2026
23	Debat publik rreth projekt propozimit të Buxhetit për vitin 2027-2029.	Korrik 2026
24	Përgatitja dhe shqyrtimi i Rregullores për vendosjen e tatimit në Pronë për vitin 2026 (varësisht nga Qarkoret Buxhetore të cilat i lëshon Ministria e Financave).	Fundi i Tetorit
25	Debati i dytë lidhur me buxhetin 2027-2029 (varësisht nga Qarkoret Buxhetore të cilat i lëshon Ministria e Financave).	Gusht 2026
26	Shqyrtimi i Raportit mbi realizimin e buxhetit për periudhën janar-shtator 2026.	Tetor 2026
27	Punët përgatitorë rreth përmbyllje së UZP sipas afateve të cilat i përcakton MEF-i -Departamenti i Thesarit.	Nentor 2026

28	Publikimi i Listave te pronave komunale per dhenejen ne shfrytëzim.Lista përgjithësime dhe e veçantë	Dhjetori 2026
29	Publikimi i raportit përmbyllës te Z.T.P	Dhjetori 2026
30	Punët përmbyllës Buxhetore	Dhjetor 2026

Drejtoria për Ekonomi Financa dhe Zhvillim do të bashkëpunojë ngushte me institucionet qeveritare të Republikës së Kosovës. Varësisht nga plani dhe programi i Ministrive përkatëse, punëtorët e këtij drejtor ati do të jenë pjesëmarrës të aktiviteteve në trajnime dhe ligjërata të cilat do të organizohen nga ministritë organizatat dhe asociacionet.

Qamil Kolloni



Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim - Komuna Dragash



Mob: 044/201-072

E-mail: Qamil.Kolloni@rks-gov.net

Web: kk.rks-gov.net/dragash/

Adresa: Sheshi Dëshmorëve 22000 Dragash



PLANI I PUNËS PËR VITIN 2026

Drejtoria e Mbrojtjes, Shpëtimit dhe Shërbimeve Publike

Nr. Br. 052/01-4/129/26
09.03.2026
Dragash - Dragaš

I. Hyrje

Plani i Punës së Drejtoratit për Mbrojtjen, Shpëtimin dhe Shërbimet Publike për vitin 2026 është hartuar në përputhje me kompetencat e Drejtoratit të përcaktuara me Statutin e Komunës së Dragashit, legjislacionin në fuqi, vendimet e Kuvendit Komunal të Dragashit, si dhe bazuar në analizën e realizimit të Planit të Punës dhe Raportit vjetor të Drejtoratit për vitin 2025.

Plani përfaqëson një dokument planifikues dhe operacional, dhe përmes zbatimit të tij sigurohet vazhdimësia e funksionimit të sistemit të mbrojtjes dhe shpëtimit, përmirësimi i shërbimeve publike dhe komunale, si dhe rritja e sigurisë dhe cilësisë së jetës së qytetarëve të Komunës së Dragashit.

II. QËLLIMET E PËRGJITHSHME DHE TË VEÇANTA PËR VITIN 2026

Qëllimet e përgjithshme:

- Përmirësimi i sigurisë së qytetarëve dhe mbrojtja e pronës;
- Forcimi i kapaciteteve për reagim në situata emergjente dhe krize;
- Përmirësimi i cilësisë dhe disponueshmërisë së shërbimeve publike dhe komunale;
- Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional dhe rajonal;
- Rritja e transparencës dhe efikasitetit të punës së Drejtoratit.

Qëllimet e veçanta:

- Përfundimi dhe miratimi i dokumenteve planifikuese në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit;
- Forcimi i mëtejshëm i Njesisë së Zjarrfikësve përmes avancimit të stafit dhe pajisjeve teknike;
- Zgjerimi i mëtejshëm i sistemit të menaxhimit të mbeturinave;
- Përmirësimi i sistemit të ndriçimit publik, furnizimit me ujë dhe kanalizimeve;
- Zhvillimi i aktiviteteve parandaluese dhe edukative për qytetarët.

II. PARAQITJE TABELARE E PLANIT TË PUNËS SIPAS TRIMUJORËVE (K1–K4)

Tabela është hartuar në përputhje me formatin e përdorur në materialet e Kuvendit Komunal të Dragashit dhe përfaqëson një pasqyrë të detajuar të aktiviteteve të planifikuara të Drejtoratit për vitin 2026.

R. br.	Fushëveprimi	Aktivitet	K1	K2	K3	K4	Vërejtje
Shërbimi për ndërhyrje emergjente dhe zjarrfikëse							
1	Njësia zjarrëfikse	Punë e rregullt operative dhe ndërhyrje	X	X	X	X	Aktivitet i vazhdueshëm
2		Punësimi i zjarrfikësve të rinj	X	X	X		Në përputhje me miratimet
3		Furnizimi me pajisje mbrojtëse dhe teknike		X	X		Mjetet buxhetore
4		Mirëmbajtja dhe regjistrimi i automjeteve	X	X	X	X	Obligim ligjor
5	Veprim parandalues	Vizita parandaluese në zonat me rrezik	X	X	X	X	Në vazhdimësi
6		Fushata për ndalimin e ndezjes së zjarrit		X	X		Sezona verore
7	Edukimi	Ligjërata në shkolla		X	X		Në bashkëpunim me shkollat
8	Vlerësimi i rrezikut	Përfundimi i Vlerësimit të rrezikut	X	X	X		Dokument me rëndësi
9	Planifikimi	Hartimi i Planit të reagimit			X	X	Pas Vlerësimit të rrezikut
10	Mbrojtja nga përmbytjet	Identifikimi i lokacioneve me rrezik	X	X			Punë në terren

11		Ndërtimi i mureve mbështetëse		X	X	X	Investime kapitale
Shërbimet Publike							
12	Menaxhimi i mbeturinave	Zgjerimi i sistemit të mbledhjes së mbeturinave	X	X	X	X	Përfshirja e fshatrave
13		Furnizimi me kontejnerë dhe pajisje		X	X		Në përputhje me planin
14		Largimi i deponive ilegale			X	X	Sipas prioritetit
15	Ndriçimi publik	Marrja e përgjegjësisë për pagesën dhe mirëmbajtjen	X	X	X	X	Vazhdueshëm
16		Vendosja e matësve të rinj		X	X		Në bashkëpunim me KEDS
17	Furnizimi me ujë	Bashkëpunimi me Hidroregjioni	X	X	X	X	Vazhdueshëm
18		Sanimi i ujës-jellësit dhe kanalizimeve		X	X		Projektet kapitale
19	Krojet publike	Kontrolli dhe mirëmbajtja	X	X	X	X	Kontrolli i konsumit
20	Bashkëpunimi	Bashkëpunimi me KFOR-in dhe institucionet	X	X	X	X	Takime të rregullta
21	Projekti	Përgatitja e projekteve ndërkombëtare	X	X	X	X	Fondet donatore
22	Administrata	Plani financiar dhe zbatimi i tij	X	X	X	X	Detyrim ligjor
23		Përgatitja e raporteve për Kuvendin				X	Raporti vjetor

IV. PËRFUNDIMI DHE VËREJTJE

Plani i Punës së Drejtoratit për Mbrojtjen, Shpëtimin dhe Shërbimet Publike për vitin 2026 përfaqëson një kuadër të gjithanshëm dhe realist të aktiviteteve të planifikuara, të cilat synojnë forcimin e sigurisë, efikasitetin e shërbimeve publike dhe kapacitetet institucionale të Komunës së Dragashit.

Zbatimi i aktiviteteve të planifikuara do të varet nga sigurimi i mjeteve buxhetore, kapacitetet e stafit dhe bashkëpunimi në kohë me institucionet kompetente, ndërmarrjet publike dhe partnerët ndërkombëtarë.

Dragash, Janar 2026



Raisa Šabani-Jelmazi

Raisa Š. J.
Drejtore

Drejtorja e Mbrojtjes, Shpëtimit dhe Shërbimeve
Publike



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republik of Kosovo
Komuna Dragash/ Opština Dragaš/ Dragas Municipality

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

Plani i punës në DKA për 2026	KOHA E REALIZIMIT												Implementues
	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	
Analaiza e suksesit të nxënësve gjatë vitit 2025/2026 në fund të gjysmëvjetorit të parë dhe të dytë (Raport në Kuvend)		V					V						DKA
Informat mbi fillimin e vitit shkollor 2025 -2026									V				DKA
Hartimi i dinamikës dhe përcjellja e fillimit të vitit shkollor. Vizitë me kryetarin e komunës, qëllimi: urim për vitin e ri shkollor	V					V			V				DKA
Përgatitja dhe regjistrimi i nxënësve, në çerdhe, parafillor dhe klasë të parë					V								DKA & Shkolla
Java e gjelbërimit për të gjitha shkollat				V	V								DKA & Shkolla

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
Komuna e Dragashit
Opština Dragaš

02 Nr. Br. 052/01-3497/26
25.02.2026
Dragash - Dragaš

[illegible]

të punës me mësimdhënës të kualifikuar							V						DKA
Formimi i komisionit për përgatitjen e testit vlerësues dhe respektimin e procedurave për përzgjedhjen e personelit arsimor							V						DKA
Organizimi i testit me shkrim dhe mbajtja e intervistës, konkursi i rregullt								V					DKA
Vlerësimi dhe përzgjedhja e personelit arsimor në bazë të konkursit të rregullt sipas, UA-iv								V					DKA
Përgatitja e vendimeve për shkuarje në pushim vjetor të punëtorëve arsimor							V						DKA
Shpallja e konkursit plotësues për regjistrimin e nxënësve në SHML								V					DKA&MASHT
Përcjellja e procedurës së regjistrimit të nxënësve në shkollat e mesme nga konkursi plotësues								V					DKA
Furnizimi i shkollave me dokumentacion pedagogjik: libra, ditarë, kalendari shkollor							V	V	V				DKA- Shkolla

[illegible]

Plani i punës për përgatitjen e lokaleve shkollore për vitin shkollor 2025/2026

Përgatitja e objekteve shkollore për vitin 2025/2026

Përgatitja teknike e lokaleve shkollore; gelqerosje, dezinfektim, vendosja e xhamave të dëmtuar, riparimi i inventarit ekzistues dhe paisja me inventar të ri							V	V				V	Shkolla&DKA
Realizimi i procedurave për përzgjedhjen e operatorit furnizues me lëndë djegëse: dru, pelet, naftë							V	V					DKA&Prokurimi
Përzgjedhja e operatorit për furnizim të shkollave me lëndë djegëse në koordinim me zyren e prokurimit								V					DKA& Prokurimi
Furnizimi i shkollave me lëndë djegëse								V					DKA

Kontrollimi i sistemeve të ngrohjes nëpër shkolla								V						DKA&Shkolla
Riparimi i nyjeve sanitare dhe përmirësimi i furnizimit të shkollave me ujë të pijëshëm							V	V	V					DKA
Furnizimi i shkollave me mjete shkollore , salla, kabinete								V	V	V				DKA&Shkolla
Furnizimi me inventar shkollor: banka, karrige, tavolina, tabela dhe dollapë për bibliotekat e shkollore							V	V	V					DKA & Shkolla
Mirëmbajtja (rregullimi) i shkollave dhe oborreve të shkollave				V	V	V	V	V	V					DKA&Shkolla
Mirëmbajtja (rregullimi) i tereneve sportive				V	V	V	V	V	V					DKA & Shkolla
Furnizimi dhe mbikqyrja e furnizimit të nxënësve me tekste shkollore							V	V	V					MASHT&DKA

Furnizimi i shkollave me mjete higjienike dhe aparate për shuarjen e zjarrit.	I përhershëm, sipas nevojës	DKA
Furnizimi i shkollave me material për administratën e shkollave	Sipas kërkesave	DKA
Furnizimi i shkollave me karburant për gjenerator	Sipas kërkesave	DKA&Shkolla
Furnizimi i shkollave me material për zhvillimin e aktiviteteve	Sipas kërkesave	DKA&Shkolla
Implementimi i pjesës që ka të bëjë me Planin Zhvillimor të DKA- së	Në vazhdimësi	DKA&KOMUNA

Aktivitetet që kanë të bëjnë me procesin edukativo – arsimor

	KOHA E REALIZIMIT												Implementues
	I	II	II I	I V	V	V I	VII	VII I	IX	X	XI	XII	
Organizimi i mësimit shtesë për maturantët						√							DKA Gjimnazi
Organizimi i trajnimeve për mësime në DKA për Ngritje Profesionale				√			√	√				√	DKA Trajnëret
Përcjellja e braktisjes së nxënësve- Raportimi 3 mujor			√				√			√			DKA Shkollat
Bashkëpunimi me OJQ në fushën e realizimit të drejtave të fëmijëve dhe sigurisë së nxënësve në shkollë, kundër trafikimit, punës së fëmijëve etj.	I vazhdueshëm sipas nevojës dhe kërkesës së shkollave												DKA OJQ-të
Analiza e punës edukativo-arsimore	√				√			√			√		DKA Shkollat
Përcjellja e lëvizjes së personelit arsimor	I vazhdueshëm, sipas nevojës së shkollave												DKA Shkollat
Plotësimi i vendeve të lira tëpunës	I vazhdueshëm, sipas nevojës së shkollave												DKA Shkollat

Vlerësimi i punës edukativo arsimore të shkollave nëpërmjet të vizitave dhe bashkëpunimit me prindër			√		√		√			√			DKA Komuna Shkollat
Përgatitja profesionale e mësimeve, organizimi i trajnimeve sipas PZhPM-se				√	√	√	√	√	√				DKA shkollat
Përgatitjet për kremtimin e festave shtetërore		√				√					√		Shkollat DKA
Organizimi i vizitave studimore me stafin e DKA-se jashtë vendit	Sipas ftesave dhe nevojës												DKA MASHT OJQ
Përcjellja permanente e aktiviteteve mësimore e jashtë mësimore të nxënësve nëpër shkolla	I vazhdueshëm												DKA Shkollat
Organizimi dhe mbajtja e garave të shkollave të tështit me klasat e 5-ta dhe të arritshmeris					√	√							DKA Shkollat
Përcjellja e realizimit të mbrëmjeve të maturës					√								DKA Shkollat
Mbarimi i mësimit per maturantët					√								MASHT DKA Shkollat

Mbarimi i mësimit për semimaturantë dhe shkolla të mesme të larta						√							MASHT DKA Shkollat
Mbarimi i mësimit për parfilloret dhe klasat 1-8						√							MASHT DKA Shkollat
Riprovimet për nxënësit që nuk kanë treguar rezultate pozitive në disa lende mësimore						√		√					DKA Shkollat
Publikimi i rezultateve të provimit shtetëror të maturës							√		√				MASHT DKA
Shqyrtimi i ankesave eventuale të parashtruara nga nxënësit							√		√				MASHT DKA Shkollat
Publikimi i rezultateve të shqyrtimit të ankesave							√		√				MASHT DKA Shkollat

**Aktiviteti dhe bashkëpunimi i DKA-se me Kryetarin e Komunës,
KKSB, MASHTI dhe me drejtoritë e tjera komunale**

	KOHA E REALIZIMIT												Implementues
	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	
Takimet dhe konsultimet me kryetarin e Komunës	I vazhdueshëm												DKA
Takimet e rregullta me ministrin e arsimit, në kuadër të takimeve me drejtoret e DKA-ve	√	√	√	√	√	√	√	√		√	√	√	DKA
Përcjellja e kërkesave, shkresave, raporteve dhe informatave nga aktiviteti i DKA-se në MASHTI	I vazhdueshëm, sipas kërkesave												DKA MASHT
Kontaktet e rregullta me Departamentin e Arsimit Parauniversitar, Infrastrukturës, Njësinë për Vlerësime dhe zyrtarë të ndryshëm arsimor	I vazhdueshëm, sipas nevojës												DKA MASHT
Pjesëmarrja e rregullt në mbledhjet e Kolegjiumit të Drejtoreve të DKA-ve të Kosovës	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√	DKA Shkollat

Koordinimi i aktiviteteve me drejtoritë e tjera komunale, si: Drejtorinë e Financave, Drejtorinë e Shëndetësisë, Urbanizimit	I vazhdueshëm, sipas nevojës										DKA Shkollat	
Bashkëpunimi i rregullt me drejtoritë e tjera komunale, si DKRS DSh	I vazhdueshëm, sipas nevojës										DKA Shkollat	
Bashkëpunimi i rregullt me Sektorin e Inspektionit të Arsimit							√	√	√			DKA SIA
Puna me pale, shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave	I vazhdueshëm, sipas kërkesave.										DKA Shkollat Etj	
Komunikimi i rregullt me IKShP-në për ta përcjellë gjendjen higjieniko sanitare ne shkolla	Sipas kërkesave dhe nevojës										Shkollat DKA	

Bashkëpunimi i DKA-se me organet e sigurisë, OJQ-të, mediat dhe komunitetin

	KOHA E REALIZIMIT												Implementues
	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	
Pjesëmarrja në debatet me temë arsimore e shoqërore organizuar nga OJO-të	I vazhdueshëm, sipas kërkesave.												DKA
Bashkëpunimi me Policinë e Kosovës, FSK-në.	I vazhdueshëm, sipas kërkesave.												DKA
Kontaktet me përfaqësues të KFOR-it dhe të organizatave ndërkombëtare	I vazhdueshëm, sipas kërkesave.												DKA Shkollat
Bashkëpunimi me organizata të ndryshme vendore e të huaja	I vazhdueshëm, sipas kërkesave.												DKA Trajnerët
Bashkëpunimi me donatore të huaj	I vazhdueshëm, sipas kërkesave.												DKA Shkollat

**Bashkëpunimi me përfaqësuesin e komunës për implementimin e
projekteve që kanë të**

bëjnë me Integrimet Evropiane

	KOHA E REALIZIMIT												Implementues
	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	
Përmirësimi i infrastrukturës, sigurimi i transportit dhe rritja e sigurisë në shkolla.			√	√	√	√			√	√	√	√	DKA Drejtorët e shkollave
Identifikimi i shkollave që kanë nevojë për ndërtim dhe renovim, si dhe hartimi i listës së prioriteteve		√	√	√									DKA Zyra e prokurimit
Përgatitjet dhe kompletimi i dokumentacioneve për projekte (parametat dhe paralogaritë) e ndërtimeve të objekteve shkollore					√	√							DKA Shkollat Zyra e prokurimit
Zgjerimi i hapësirave ekzistuese shkollore (renovimi) dhe mbikëqyrja e punëve gjatë renovimeve						√	√	√	√				DKA Zyra e projekteve Zyra e prokurimit
Identifikimi i nevojave për materiale dhe pajisje, si dhe përcaktimi i prioriteteve të shkollave me nevojë të theksuara	I vazhdueshëm, sipas kërkesave.												DKA Shkollat
Implementimi i Strategjisë për Arsimin													DKA Zyra për kthim dhe komunitet

e Komuniteteve	I vazhdueshëm, sipas nevojave.	Shkollat
Përfshirja e fëmijëve të komuniteteve në arsim si dhe përfshirja në edukimin parashkollor	I vazhdueshëm, sipas nevojave.	DKA Zyra për kthim dhe komunitet Shkollat
Zbatimi i projekteve për sensibilizimin e nevojës së shkollimit të fëmijëve të komuniteteve	I vazhdueshëm, sipas nevojave.	DKA Zyra për kthim dhe komunitet Shkollat
Zbatimi i planit të veprimit për parandalimin e braktisjes dhe të mos regjistrimit të shkollimit për komunitetet jo shumice (komfor strategjisë për përfshirjen e komuniteteve në shoqërinë kosovare	I vazhdueshëm, sipas kërkesave.	DKA Zyra për kthim dhe komunitet Shkollat

Investimet kapitale në shkollat e Komunës së Dragashit për vitin 2026

Nr.	Investimet kapitale
1.	Ndërtimi i këndit të lojërave, kubëzimi, demolimi i shkollës së vjetër "28 Nëntori" në fshatin Bresanë (projekt dy vjeçar)
2.	Ndërtimi i stadiumit dhe infrastrukturës përcjellëse në fshatin Kosavë
3.	Rehabilitimi i stadiumit në shkollën fillore "Sezai Surroi" në fshatin Bellobrad
4.	Renovimi i të gjitha shkollave të Regjionit të Gorës

Dragash,

Drejtori i Arsimit

Zeni Krasniqi





Republika e Kosoves
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunes Dragash
Skupština Opštine Dragaš
Municipal Assambly Dragas

Drejtoria per urbanizem, kadaster dhe mbrojtje te mjedisit
Direktorijati za urbanizam, katastar i zaštiti sredine
Directorate for urbanism, cadastre and environment protectiona

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
Komuna e Dragashit
Opština Dragaš

02 Nr. Br. 052/01-3676/20
27.02.20 RC
Dragash - Dragash

PLANI I PUNËS PËR VITIN 2026

I. HYRJE

Plani i punës i Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtjen e Mjedisit për vitin 2026 është përgatitur në përputhje me:

- Ligjin për planifikim hapësinor,
- Ligjin për ndërtim,
- Ligjin për kadastrën e pronave të paluajtshme nr. 08/L-237,
- Ligjin për procedurën administrative të përgjithshme,
- Ligjin për mbrojtjen e mjedisit,
- Ligjin për vetëqeverisjen lokale të Kosovës,
- Ligjin për Parkun Kombëtar "Shar",
- Udhëzime administrative relevante për zbatimin e ligjeve të lartpërmendura,
- Statutin e Komunës së Dragashit,
- Buxhetin e Komunës së Dragashit për vitin 2026.

Sipas Buxhetit për vitin 2026, për investimet kapitale në kompetencë të Drejtorisë së Planifikimit Urban, janë të alokuara fonde në shumën 3.667.818 €, me qëllim strategjik që realizimi i buxhetit të jetë nga 90% deri në 100%.

II. QËLLIMET STRATEGJIKE PËR VITIN 2026

Drejtoria gjatë vitit 2026 do të fokusohet në:

- realizimin efikas të projekteve kapitale,
- përmirësimin e planifikimit urbanistik dhe miratimin e ORP,
- dixhitalizimin dhe riorganizimin e shërbimeve kadastrale,
- forcimin e mbrojtjes pronësore dhe ligjore të pronës komunale,
- përmirësimin e mbrojtjes së mjedisit,
- përmirësimin e sistemit të adresave të komunës,
- rritjen e transparencës dhe ligjshmërisë së punës.

III. SEKTORI I URBANIZMIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSOR

1. Realizimi i investimeve kapitale për vitin 2026

Në vitin 2026, prioritet është realizimi i projekteve kapitale në vlerë 3.667.818 €, duke përfshirë gjithsej 69 projekte, prej të cilave 22 projekte dyvjeçare të filluara në 2025 (pa procedurë të re tenderimi), 49 projekte të reja të planifikuara për vitin 2026.

Qëllimet kryesore janë:

- arritja e realizimit të buxhetit nga 90% deri në 100%,
- mbikëqyrje e vazhdueshme mbi zbatimin e punimeve,
- përmirësimi i cilësisë së dokumentacionit teknik.

2. Rritja e efikasitetit në lëshimin e lejeve

Aktivitetet e planifikuara për këtë qëllim përfshijnë:

- rritjen e numrit të lejeve ndërtimore të lëshuara,
- rritjen e numrit të kushteve urbanistike të lëshuara,
- shkurtimin e afateve për zgjidhjen e lëndëve,
- zbatimin e plotë të Ligjit për Ndërtim dhe akteve nënligjore,
- përmirësimin e punës përmes sistemeve elektronike (e-sistemeve).

3. Përgatitja e dokumentacionit planifikues

Në bashkëpunim me operatorin ekonomik që do të përzgjidhet për:

- përgatitjen e Planit Zhvillimor Komunal,
- përgatitjen e hartave zonale,

- përgatitjen e planeve të detajuara rregullatore (DRP) për:
 1. qendrën administrative të Dragashit,
 2. zonën industriale,
 3. zonat e treta të Parkut Kombëtar “Sharr” (Zaplluxhe, Restelicë dhe Brod),

planifikohet si më poshtë:

1. Përgatitja dhe përcaktimi i detyrës

- Dorëzimi i të gjitha dokumenteve planifikues ekzistuese, të dhënave, kadastrës, infrastrukturës dhe statistikave demografike.
- Përcaktimi i qëllimeve të zhvillimit të komunës (ekonomi, turizëm, bujqësi, infrastrukturë).
- Harmonizimi i detyrës projektuale me operatorin ekonomik.

2. Koordinimi profesional

- Formimi i një grupi pune brenda komunës.
- Pjesëmarrja e rregullt në takimet me operatorin ekonomik.
- Dhënia e vërejtjeve dhe sugjerimeve për çdo fazë të draftit të planit.
- Kontrollimi që plani të jetë në përputhje me ligjet për planifikim hapësinor.

3. Konsultimet publike

- Organizimi i diskutimeve publike.
- Përfshirja e qytetarëve, bizneseve, njësive administrative dhe institucioneve.
- Mbledhja dhe sistematizimi i vërejtjeve.

4. Kontrolli i cilësisë

Verifikimi që të jenë:

- të përcaktuara zonat zhvillimore,
- e parashikuar infrastruktura,
- në përputhje me dokumentet më të larta planifikuese,
- të vlerësuara realistisht kostot financiare.

5. Procedura e miratimit

- Përgatitja e raportit për procedurën e kryer.
- Dërgimi i planit për shqyrtim në Kuvendin e Komunës.

Qëllimi: të vendoset një zhvillim planifikues dhe i qëndrueshëm i komunës.

IV. SEKTORI I KADASTRËS – Zyra Komunale Kadastrale

1. Riorganizimi i Zyrës Komunale Kadastrale

Bazuar në Ligjin për Kadastrën e Pronave të Paluajtshme, rekomandimet e Agjencisë Kadastrale të Kosovës – Prishtinë, dhe vendimin e drejtorit, është kryer riorganizimi i ZKK Dragash, ku janë caktuar punonjës të Drejtorisë për të trajtuar dhe ofruar shërbime.

Masat e planifikuara:

1. Riorganizim funksional i ZKK-së,
2. Harmonizim i plotë me Ligjin për Kadastrën e Pronave të Paluajtshme,
3. Forcimi i lidhjes vertikale me Agjencinë Kadastrale të Kosovës (AKK),
4. Zbatimi i plotë i sistemeve e-Katastar dhe e-Geometar,
5. Kalimi në operim plotësisht online.

2. Përmirësimi i shërbimeve kadastrale

Plani përfshin:

1. Rritjen e efikasitetit në përpunimin e lëndëve,
2. Zvogëlimin e lëndëve të mbetura,
3. Dixhitalizimin e arkivit,
4. Trajnime të vazhdueshme për punonjësit,
5. Marrjen e çdo vendimi brenda afatit të parashikuar nga ligji,
6. Dërgimin e rregullt të vendimeve tek palët përmes email-it dhe kanaleve të tjera të lejuara ligjërisht.

V. SEKTORI PËR ÇËSHTJET PRONËSORE DHE LIGJORE

1. Legalizimi dhe regjistrimi i objekteve

Gjatë vitit 2026 planifikohet:

- identifikimi i objekteve të ndërtuara pa leje,

- regjistrimi i objekteve ku është uzurpuar toka shoqërore,
- harmonizimi i gjendjes në terren me regjistrat kadastralë.

2. Rishikimi i vendimeve të paligjshme nga periudha e mëparshme

Masat e planifikuara përfshijnë:

- rishikimin e vendimeve të mëparshme për dhënien e tokës,
- fillimin e procedurave për shfuqizimin e vendimeve të paligjshme,
- mbrojtjen e pronës komunale.

VI. SEKTORI I MBROJTJES SË MJEDISIT

1. Aktivitetet në terren

Gjatë vitit 2026 planifikohet:

- intensifikimi i mbikëqyrjes inspektuese në terren,
- identifikimi dhe eliminimi i shkeljeve në fushën e mbrojtjes së mjedisit,
- bashkëpunimi me ministrinë përkatëse.

2. Bashkëpunimi me Parkun Kombëtar “Shar”

Aktivitetet e planifikuara përfshijnë:

- kontrole të përbashkëta në zonat e mbrojtura,
- rritjen e numrit të vizitave në terren,
- eliminimin e parregullsive të konstatuara,
- forcimin e mbrojtjes së resurseve natyrore.

3. Rritja e ndërgjegjësimit

- aktivitete edukative për qytetarët,
- bashkëpunim me shkollat dhe sektorin e OJQ-ve,
- promovimi i zhvillimit të qëndrueshëm.

VII. SHËRBIMI PËR SISTEMIN E ADRESAVE

Shërbimi për Sistemin e Adresave do të vazhdojë punën gjatë vitit 2026 për përmirësimin dhe krijimin e plotë të regjistrit të adresave në territorin e Komunës së Dragashit.

1. Zgjatja e afatit

Për t'u mundësuar qytetarëve të bëjnë regjistrimin dhe harmonizimin e adresave të tyre:

- afati për futjen dhe verifikimin e adresave është zgjatur deri në fund të gushtit 2026,
- shërbimi do të ofrojë mbështetje teknike të shtuar për qytetarët,
- do të bëhet përditësim i vazhdueshëm i bazës së sistemit të adresave.

2. Aktivitetet e planifikuara

- mbledhja dhe verifikimi i të dhënave të adresave,
- mundësimi për qytetarët që të fusin dhe korrigjojnë adresat,
- kontrole në terren sipas nevojës,
- bashkëpunim me Agjencinë Kadastrale të Kosovës,
- informimi i qytetarëve përmes kanaleve publike.

3. Rezultatet e pritura

- rritja e numrit të adresave të regjistruara,
- zvogëlimi i mos-përputhjeve në regjistrin e adresave,
- përmirësimi i saktësisë së të dhënave hapësinore.

VIII. PUNËT ADMINISTRATIVE DHE FINANCIARE

Drejtorja gjatë vitit 2026 do të:

1. nxjerrë akte administrative në përputhje me **Ligjin për Procedurën Administrative të Përgjithshme**,
2. përmirësojë mbledhjen e taksave dhe tarifave komunale përmes pagesës elektronike,
3. zhvillojë procedura të ligjshme dhe transparente,
4. përmirësojë kontrollin e brendshëm.

IX. BASHKËPUNIMI

Drejtorja do të intensifikojë bashkëpunimin me:

1. drejtoritë e tjera të **Komunës së Dragashit**,
2. ministritë e Qeverisë së Kosovës,
3. **Agjencinë Kadastrale të Kosovës**,
4. zyrën e **Parkut Kombëtar "Sharr"**,
5. donatorët dhe partnerët ndërkombëtarë,
6. operatorët ekonomikë.

X. MONITORIMI I REALIZIMIT

Zbatimi i këtij plani do të monitorohet çdo 3 muaj përmes:

1. raporteve çerekvjetore mbi realizimin,
2. analizës së realizimit financiar dhe fizik,
3. monitorimit të efikasitetit të sektorëve,
4. marrjes së masave korrigjuese ku është e nevojshme.

Qëllimi strategjik mbetet realizimi i buxhetit kapital mbi 90%.

XI. PËRFUNDIMI

Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtjen e Mjedisit gjatë vitit 2026 do të veprojë në mënyrë proaktive, ligjore dhe me orientim zhvillimor, me fokus të qartë në:

1. realizimin e investimeve kapitale në vlerë 3.667.818 €,
2. përfundimin e 22 projekteve dyvjeçare (2025–2026),
3. realizimin e 49 projekteve të reja,
4. dixhitalizimin e plotë të punës së Zyrës Komunale Kadastrale (ZKK),
5. përmirësimin e sistemit të adresave,
6. mbrojtjen e pronës komunale,
7. përmirësimin e mjedisit,
8. miratimin e Planit Zhvillimor Komunal.



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
REPUBLIC OF KOSOVO



Kuvendi Komunal Dragash – Skupština Opštine Dragaš – Municipality of Dragash
Drejtoria për Bujqësi, Inspeksion, Turizëm, Pylltari dhe Zhvillim Rural
Direktorijati za Poljoprivredu, Inspekciju, Turizm, Šumarstvo i Ruralni Razvoj
Directorate for Agriculture, Inspections, Tourism, Forestry and Rural Development

DATA/DATUM:	26/01/2026
REFERENCE-E:	09/Nr.
PËR/ZA/TO:	Zyrës së Kryetarit të Komunës së Dragashit
CC:	
PERMES/PREKO/THROUGH:	Shërbimi i Përkthimit i Kuvendit Komunal
NGA/OD/FROM:	Drejtoria për Bujqësi, Inspeksion, Turizëm, Pylltari dhe Zhvillim Drejtori: Enes Goran
TEMA/SUBJEKT/SUBJECT:	PLANI I PUNËS PËR VITI 2026

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Statutit të Komunës së Dragashit, si dhe vendimeve të Kryetarit të Komunës së Dragashit, Drejtori i Drejtorisë për Bujqësi, Inspeksion, Turizëm, Pylltari dhe Zhvillim Rural paraqet këtë Plan Pune për vitin 2026.

Plani Vjetor i Drejtorisë për Bujqësi, Inspeksion, Turizëm, Pylltari dhe Zhvillim Rural përfshin periudhën nga 02.01 deri më 30.12.2026. Koncepti i këtij plani është hartuar me një qasje fleksibile, duke mundësuar përshtatjen ndaj ndryshimeve eventuale, si dhe harmonizimin kohor me zhvillimet dhe dinamikat reale në Komunën e Dragashit.

Objektivat kryesore të këtij plani janë: rritja e efikasitetit dhe funksionalitetit të Drejtorisë, mbajtja e kontakteve të drejtpërdrejta dhe bashkëpunimi i vazhdueshëm me drejtoritë e tjera, ministrinë përkatëse, palët e interesuara dhe institucionet ndërkombëtare, si dhe siguri i disiplinës në punë në një nivel që garanton funksionim të ligjshëm dhe profesional të Drejtorisë.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
Komuna e Dragashit
Opština Dragaš

02 Nr. Br. 052/09-3612/26
26.01.2026
Dragash - Dragaš

PLANI I PUNËS PËR VITIN 2026

SEKTORI PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL

Komuna e Dragashit përmes politikave dhe strategjive zhvillimore është e orientuar në mbështetje të faktorëve të prodhimit, në stimulimin e fermerëve dhe në krijimin e një ambienti sa më të favorshëm zhvillimor. Bujqësia dhe Zhvillimi Rural janë sektorët të cilët mund të kontribuojnë dukshëm në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit.

Duke patur parasysh se hartimi i politikave bujqësore shtetërore është e përcaktuar dhe orientuar nga MBPZHR dhe nuk ka kompetenca të drejtpërdrejta Komuna për përcaktimin apo zbatimin e politikës bujqësore shtetërore, përveç në disa kompetenca të lejueshme me ligjshmëri. Megjithatë, sektori për bujqësi dhe zhvillim rural e që është më afër fermerëve, ka një rol të rëndësishëm në zhvillimin e bujqësisë.

Objektivat kryesore të sektorit

1. Krijimi i kushteve për rritjen e kapaciteteve prodhuese, menaxhim të qëndrueshëm të resurseve natyrore (tokën, pyjet, kullosat dhe ujin) modernizimi i bujqësisë, tërheqja e investimeve për të krijuar një mjedis favorizues për rritjen e mirëqenies së qytetarëve në viset rurale të Komunës së Dragashit.
2. Zbatimi i projekteve të hartuara gjatë planifikimit, me qëllim të përmirësimit të kushteve të jetës dhe punës përmes:
 - Investimeve kapitale (Infrastrukturë të zhvillimit rural)
 - Ofrimi i Këshillave për fermer mbi teknologjitë e reja në prodhimtarin bujqësor;
 - Subvencionimet në sektorin e bujqësisë,
 - Hulumentimi i burimeve financiare për sektorin e bujqësisë,
 - Mbështetje për iniciativat e fermerëve në ngritjen e cilësisë dhe sasisë të prodhimeve bujqësore, produkteve vendore e lokale si dhe Promovimin e tyre.
3. Bashkëpunimi me institucionet qeveritare dhe jo-qeveritare, vendore dhe ndërkombëtare, biznesin lokal dhe të jashtëm, drejt realizimit të projekteve zhvillimore komunale për një ambient më të mirë të zhvillimit ekonomiko-bujqësor.

Aktivitetet:

-Bashkëpunimi me MBPZHR dhe Zyrën Rajonale (Janar-Dhjetor) : Lidhur me zhvillimin e projekteve, seminareve, kërkesave për mbështetje, raporteve-informacioneve, njoftimeve, ndihmës së fermerëve për projekte nga programet e ndryshme të subvencioneve dhe granteve.

-Subvencione dhe grante:

- Organizimi dhe pjesëmarrja aktive e shërbimit për implementimin e projekteve të subvencionimit dhe fondeve të granteve për fermer dhe përpunues bujqësorë (njoftimi për kriteret e aplikimit të përcaktuara nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, pranimi i dokumenteve për aplikim dhe përcjellja deri në përfundim të pagesave).

- **Shërbimi këshillimor :** Organizimi i trajnimeve për fermer në bashkëpunim me MBPZHR (Janar-Dhjetor)

- Përpunimi dhe raportimi i të dhënave statistikore të mbjelljeve pranverore-vjeshtore dhe monitorimi dhe raportimi i korrje-shirjeve.

-Bashkëpunimi me donatorët dhe Investitorë vendas dhe të huaj për zhvillimin e bujqësisë (Janar-Dhjetor):

Bashkëpunimi me donator ndërkombëtar në fushën e zhvillimit rural, krijimi i projekteve të reja dhe zbatimi i tyre, kërkesa për rivendosje të bashkëpunimit, si UNDP, HELVETAS,

Caritas Zvicëran, GIZ, FAO, TIKA, USAID etj dhe kërkesa të vazhdueshme për bashkëpunim dhe harmonizim në implementim të aktiviteteve për zhvillimin e bujqësisë dhe zhvillim rural në Komunën e Dragashit.

-Bashkëpunimi me Parkun Kombëtar "Sharri" (Mars-Maj) lidhur me realizimin e projekteve për bujqësi të komunës dhe drejtorisë brenda kufijve të parkut. Mbështetja e fermerëve- ndihma e fermerëve për realizimin e kontratave për shfrytëzimin e kullotave me lartësi të madhe për kullotje sezonale brenda kufijve "Parku Kombëtar Sharri, si dhe bashkëpunimi i vazhdueshëm me administratën e parkut kombëtar Sharri në realizimin e planeve vjetore.

-Bashkëpunimi me fermer, shoqata dhe grupe të fermerëve (Janar-Dhjetor): Çdo muaj konsultime profesionale, trajnime për ngritje të kapaciteteve dhe promovim sa më të mirë të produkteve, me theks të veçantë në prodhimin blegtoral. Në kërkim të një zgjidhjeje për kërkesat, problemet dhe nevojat e fermerëve. Vizita e qumështoreve dhe pikat e grumbullimit të produkteve blegtorale, pikat e grumbullimit të bimëve mjekuese dhe frutave malore në komunën tonë.

-Subvencionimi i fermerëve (Shtator-Dhjetor): Mbështetja me pagesa direkte për fermerët brenda mundësive të buxhetit komunal –linja subvencione dhe transfere. Përgatitja e thirrjes për aplikim dhe implementimi deri në pagesa finale të fermerëve.

-Organizimi i panaiereve dhe ekspozitave bujqësore (Korrik-Tetor): Organizimi i Panairit me produkte vendore lokale dhe gjetja e mundësive për mbështetje të fermerëve për pjesëmarrje dhe prezencë të fermerëve tanë në panaiert tjera në Republikën e Kosovës. Po ashtu planifikohet të organizohet aktiviteti Ekspozita Qenit Ilir të Sharrit.

-Vaksinimi i kafshëve- planifikohet Vaksinimi i qenve me pronar kundër sëmundjes së Tërbimit si dhe dehelmetizimi i tyre. Synohet që brenda mundësive buxhetore të kryhet vaksinimi i deleve dhe gjedheve kundër sëmundjeve (Shtator-Dhjetor).

-Mbajtja e takimeve me bletarët (Maj-Qershor): Sëmundjet, këshillim për mundësitë e organizimit të seminareve dhe trajnimeve për zhvillimin e bletarisë.

-Bashkëpunimi me Grupi Lokal i veprimit Bio Sharri (GLV Bio Shari): Bashkëpunimi në Implementimin e projektit: Përgatitja dhe zbatimi i strategjive të zhvillimit lokal – qasja LEADER i mbështetur nga MBPZHR e implementuar nga GLV Bio Sharri.

-Krijimi-hartimi i kërkesave dhe projekteve konceptuale: Për donatorët potencialë me bashkëfinancimin e Komunës.

-Bashkëpunimi me ambasada të shteteve mike: Takime, përfaqësimi i komunës sonë, promovimi dhe reklamimi i resurseve natyrore dhe produkteve tona bujqësore, kërkimi i ambasadave që të organizohen dhe të gjejnë bashki për binjakëzimin me komuna të ngjashme si e jona për zhvillimin e blegtorisë, bujqësisë dhe turizmit, duke kërkuar investime nga vendet dhe organizatat e tyre.

-Punë Administrative komunale (Janar-Dhjetor): pranimi i kërkesave dhe shqyrtimi i tyre, puna në komisione komunale, puna në teren, etj.

INSPEKTORATI

Detyra themelore e inspektoratit është mbikëqyrja dhe kontrolli i të gjitha veprimtarive me qëllim që qytetarëve t'u ofrohen shërbime më cilësore, më të sigurta dhe më efikase, duke garantuar mbrojtjen e konsumatorit dhe duke qenë në shërbim të kërkesave të tyre. Njëkohësisht, synohet bashkëpunim i vazhdueshëm me drejtoritë e tjera për ofrimin e asistencës së ndërsjellë.

Inspektorati i Tregut

- Mbikëqyrja dhe zbatimi i ligjeve përkatëse, si Ligji për Inspektoratin e Tregut, Ligji për Tregtinë e Brendshme, Ligji për Mbrojtjen e Konsumatorit, Ligji për Njësitë Matëse, si dhe dispozitat përkatëse të ligjeve, udhëzimeve administrative dhe rregulloreve të tjera që ndërlidhen me këtë fushë.
- Vizita dhe kontrole në terren të subjekteve afariste në territorin e Komunës së Dragashit.
- Luftimi i ekonomisë joformale dhe aktiviteteve të paligjshme.
- Ofrimi i këshillave profesionale për bizneset me qëllim eliminimin e parregullsive gjatë ushtrimit të veprimtarisë.
- Identifikimi i subjekteve të paregjistruara dhe mbështetja në procesin e regjistrimit dhe licencimit të tyre në Komunën e Dragashit.
- Informimi i bizneseve për iniciativa të reja, rekomandime dhe ndryshime ligjore, duke marrë parasysh zhvillimin e shpejtë të teknologjisë, ekonomisë dhe tregut.
- Shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave të qytetarëve.

Inspektorati Komunal

- Zbatimi i ligjeve dhe rregulloreve që lidhen me rendin dhe interesin publik.
- Mbrojtja e mjedisit nga ndotja e shkaktuar nga individë apo subjekte të ndryshme.
- Kontrolli dhe menaxhimi i hapësirave publike, si dhe mbikëqyrja e sistemeve të ujësjellësit dhe kanalizimit.
- Inspektime të përbashkëta në terren me inspektorate të tjera për subjektet afariste.
- Trajtimi i kërkesave dhe shqetësimeve të qytetarëve.

Inspektorati i Ndërtimit

- Zbatimi i ligjeve dhe rregulloreve që rregullojnë ndërtimin në të gjithë territorin e Komunës së Dragashit.
- Kontrolli i objekteve për pajisje me leje ndërtimi, si dhe verifikimi i grupeve punuese nëse janë të regjistruara si subjekte afariste.
- Pjesëmarrja në komisionin komunal për vlerësimin e tenderëve.
- Mbrojtja e pronës publike dhe parandalimi i uzurpimit të rrugëve publike apo ndërtimit të paligjshëm mbi to.
- Shqyrtimi i kërkesave të qytetarëve.

PYLLTARIA

- Vazhdimi i bashkëpunimit të ngushtë dhe të gjithanshëm me Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe me Agjencia Pyjore e Kosovës.



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
Komuna Dragash – Opština Dragaš – Municipality of Dragash
Drejtoria per shëndetësi dhe mirëqenies sociale
Direktorijat za zdravstvo i socijalno staranje

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
Komuna e Dragashit
Opština Dragaš

02 Nr. Br. 052/01-3577/26
26.02.2026
Dragash - Dragaš

**Plani i punës i Drejtoratit të Shëndetësis dhe Mirëqenies Sociale për
periudhën**

Janar – Dhjetor 2026

Drejtör

Behar Brenoli

Dragash: Janar 2026

Në bazë të dispozitave ligjore dhe Statutit të Komunës së Dragashit, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ka kryer draft plan-programin dhe aktivitete që do të zbatohen në periudhën Janar – Dhjetor të vitit 2026.

Qëllimi i përgjithshëm

Ofrimi i kujdesit shëndetësor primar për banorët e komunës së Dragashit, përmes zbatimit të konceptit të mjekësisë familjare në sistemin unik shëndetësor të Republikës së Kosovës

Siguron ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare brenda territorit, sipas standardeve të vendosura nga MPMS.

- Shërbimet shëndetësore për zhvillimin, parandalimin, trajtimin, shërimin dhe rehabilitimin e sëmundjeve, çrregullimeve dhe lëndimeve;
- Edukimi shëndetësor dhe shërbimet e parandalimit, imunizimi dhe vaksinimit.
- Përcaktimi i diagnozës fillestare dhe kujdesin esencial shëndetësor, kujdesin akut, duke përfshirë kujdesin emergjent, stabilizimin dhe transportin në institucionet përkatëse, kujdesin e sëmundjeve kronike dhe intervenime kirurgjikale më të vogla;
- Kujdesi në shtëpi përmes vizitave në komunitet;
- Personeli shëndetësor dhe edukimi i popullsisë, imunizimi dhe vaksinimi;
- Përcaktimi i diagnozës fillestare dhe kujdesit bazë shëndetësor, duke përfshirë edhe intervenimet e vogla kirurgjikale;
- Promovimi i shëndetit oral i cili e parandalon kariesin e dhëmbëve si kujdesin bazë dentar;
- Sigurimi i shërbimeve shëndetësore diagnostike - analiza laboratorike dhe të rentgenit në kuadër të kujdesi shëndetësor primar;
- Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i personelit shëndetësor dhe jo mjekësor;
- Menaxhimi dhe shpërndarja e ilaçeve nga lista esenciale;
- Të afrohen shërbimet më afër popullatës.

Aktivitetet

- Kontrollimi dhe menaxhimi i buxhetit.
- Renovimi dhe mirëmbajtja e objekteve shëndetësore në trevën e Gorës/vazhdim;
- Zbatimi i statutit të ri të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Dragash dhe themelimi i organit sipas Statutit të ri;
- Renovimi i instalimeve dhe dysHEMEVE në Qendrën për Punë Sociale si dhe kulmi;
- Furnizimi me pajisje mjekësore;
- Vaksinimi i rregullt i fëmijëve si dhe kundër gripit sezonal dhe vaksinat e tjera;
- Furnizim me barna, material mjekësor dhe pajisje.
- Vizita sistematike të fëmijëve në shkollat fillore dhe të mesme të ulëta.
- Vizita në shtëpi për gratë shtatzëna dhe fëmijët nga 0-3 vjet.
- Ekzaminime të specializuara në QKMF (oftalmolog, internist, neuropsikiatër, gjinekolog dhe të tjerë)
- Ekipet mobile për të moshuarit në vende ku nuk kemi objekte shëndetësore.
- Edukimi dhe trajnimi i stafit për ofrimin e shërbimeve më të mira për qytetarët (me theks te mjekët por edhe stafi tjetër);
- Projekti "Mbështetja e Komunitetit", Ndërtimi i shtëpive për strehim social të cilin e realizon Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në bashkëpunim me DSHMS. Si dhe projekti „Strehim adekuat për shtëpi private dhe ndërtimin e ndërtesës për banesa sociale”
- Shërbimet sociale profesionale të ofruara me ligj, si dhe asistenca sociale;
- Krijimi i organit të kujdestarisë në Qendrën për Punë Sociale, si dhe organeve të tjera të parashikuara me akte ligjore.



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Dragashit / Opština Dragaš / Dragash Municipality
Drejtoria për Kulturë, Rini e Sport



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
Komuna e Dragashit
Opština Dragaš

02 Nr. Br. 002/01 - 3745/26
02.03.2026
Dragash - Dragaš

PLANI I PUNËS PËR VITIN 2026

Në përputhje me Statutin e Komunës, detyrat e përgjegjësitë e saj ligjore, Drejtoria e Kulturës, Rinisë e Sportit paraqet planin e punës për vitin 2026 mbi bazën e këtyre aktiviteteve të paraqitura në mënyrë tabelore:

Nr.	Aktiviteti	Institucioni udhëheqës dhe mbështetës
1.	Flaka e Janarit	<i>DKRS</i>
2.	17 Shkurti - Dita e Pavarësisë së Republikës së Kosovës	<i>DKRS</i>
3.	5 Marsi – Epopeja e UÇK-së	<i>DKRS</i>
4.	7 Prilli – Dita Ndërkombëtare e Sportit dhe Paqes	<i>DKRS</i>
5.	9 Maji - Dita e Evropës	<i>DKRS</i>
6.	Festivalet për fëmijë / rinore	<i>DKRS</i>
7.	Ora letrare kushtuar Ymer Prizrenit	<i>DKRS</i>
8.	15 Qershori - Dita e Çlirimit të Dragashit	<i>DKRS</i>
9.	Festivali Ballkanik i Valleve „Opoja Vallëzon“	<i>DKRS</i>
10.	Dita e Goranëve	<i>DKRS</i>
11.	Dita e Boshnjakëve	<i>DKRS</i>
12.	Ditët e Diasporës	<i>DKRS</i>
13.	28 Nëntori - Dita e Flamurit kombëtar	<i>DKRS</i>
14.	Dita e Rinisë	<i>DKRS</i>
15.	Organizimi i aktiviteteve për shënimin e Ditës së Fëmijëve - 1 Qershori	<i>DKRS – DKA - DSHMS</i>
16.	Promovimi dhe fuqizimi i Këshillave të nxënësve	<i>DKRS – DKA</i>
17.	Krijimi i klubeve për rini në zonat rurale	<i>DKRS – DKA</i>
18.	Organizimi i trajnimit për lidërsip, trajnimeve të shkathtësive të buta (Soft skills)	<i>DKRS – DKA</i>
19.	Organizimi i fushatave dhe aktiviteteve për ngritjen e vetëdijes së të rinjve lidhur me fenomenin e „bulling“, ngacmimet e dhunën fizike, emocionale e psiqike dhe „cyber – bulling“	<i>DKRS – DKA</i>

20.	Organizimi i fushatave dhe aktiviteteve për promovimin e shëndetit mendor në shkolla dhe klube të rinjve	<i>DKRS – DKA</i>
21.	Hulumtimi i nevojave të rinjve	<i>DKRS – DKA</i>
22.	Trajnimi për hartimin e projekteve	<i>DKRS – DKA</i>
23.	Trajnime në fushën e IT-së	<i>DKRS – DKA</i>
24.	Organizimi i tryezës me temën “Dukuritë negative në shkolla dhe mënyra e parandalimit të këtyre dukurive”	<i>DKRS – DKA</i>
25.	Organizimi i turneve sportive në shkollat fillore dhe të mesme	<i>DKRS – DKA</i>
26.	Organizimi i aktiviteteve me vullnetarë në mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore	<i>DKRS</i>
27.	Organizimi i shfaqjeve teatrale për fëmijë	<i>DKRS</i>
28.	Vizita të rregullta me nxënës në objekte kulturore – historike	<i>DKRS</i>
29.	Përkrahje për krijimin e Klubeve të Gjëlbra në shkollat fillore e të mesme	<i>DKRS – DKA - DSHMS</i>
30.	Organizimi i fushatave dhe aktiviteteve vetëdijesuese për shënimin e ditëve ndërkombëtare për mbrojtjen e ambientit	<i>DKRS – DKA- DSHMS</i>
31.	Organizimi i aktiviteteve për promovimin e përdorimit të biçikletave	<i>DKRS – DKA - DSHMS</i>
32.	Organizimi i aktiviteteve për rritjen e hapësirave të gjëlbra (parqeve) në qytet dhe zonat rurale	<i>DKRS – DKA - DSHMS</i>
33.	Ndërtimi i këndeve të lojërave për fëmijë	<i>DKRS – DKA</i>
34.	Ndërtimi i terreneve sportive	<i>DKRS – DKA</i>
35.	Bashkëpunimi me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për realizimin e projekteve për të gjithë sektorët, sa herë që paraqiten kërkesat	<i>DKRS - MKRS</i>
36.	Subvencionimi i organizatave dhe klubeve sportive ekzistuese	<i>DKRS</i>
37.	Themelimi i klubeve të reja sportive dhe ofrimi i mbështetjes materiale për ato	<i>DKRS</i>
38.	Përmirësimi i infrastrukturës sportive	<i>DKRS</i>
39.	Bashkëpunimi me OJQ-të ndërkombëtare e vendore për restaurimin e objekteve të trashëgimisë kulturo- historike	<i>DKRS – OJQ-të</i>
40.	Furnizimi me libra i bibliotekave	<i>DKRS – MKRS</i>
41.	Organizimi i javës së bibliotekës në nivel qendror dhe lokal	<i>DKRS</i>

42.	Renovimi i objekteve te bibliotekave dhe shtëpive të kulturës	DKRS
43.	Ndërtimi i objektit të ri për bibliotekën në Dragash	DKRS
44.	Hartimi dhe finalizimi i politikave e projekteve për zhvillimin dhe edukimin e të rinjve	DKRS
45.	Në bashkëpunim me Zyrën Ligjore do të intensifikohen angazhimet për hartimin e rregullores për licencimin dhe mënyrën e funksionimit të Qendrave Rinore në territorin e Komunës së Dragashit, funksionalizimin e Këshillit të Veprimit Rinor Lokal (KVRL)	DKRS – ZYRA LIGJORE
46.	Miratimi i Planit të Veprimit Rinor Lokal në Asamblenë Komunale	DKRS
47.	Do të vazhdohet bashkëpunimi dhe do t'u ofrohet ndihmë të gjithë individëve e shoqatave, apo klubeve me karakter kulturor, sportiv dhe rinor në territorin e komunës	DKRS
48.	Aktivitete sportive me punëtorë dhe zyrtarë të të gjitha drejtorive në kuadër të Komunës së Dragashit	DKRS

Drejtoria për Kulturë, Rini e Sport

Drejtoresha

Liridona Misinaj



[Handwritten signature of Liridona Misinaj]